



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-005

Prishtinë, më 3 mars 2011, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 3 MARS 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Para procedimit me pikat e rendit të ditës, kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit se janë parashtruar dy kërkesa me të njëjtën materie, që kanë të bëjnë me debatin parlamentar lidhur me dialogun ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për debat parlamentar lidhur me dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë,
2. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për të diskutuar lidhur me bisedimet Kosovë – Serbi.

1. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për debat parlamentar lidhur me dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për debat parlamentar lidhur me dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, **vendosi** që për këtë çështje të debatohet në mbledhjen plenare, **më 7 mars 2011, me fillim në orën 10:00.**

2. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme lidhur me bisedimet Kosovë- Serbi

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme lidhur me bisedimet Kosovë-Serbi, **konstatoi** se kjo kërkesë nuk është në pajtim me nenin 69, paragrafin 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilës Kuvendi mbledhet në seancë të jashtëzakonshme: më kërkesë të presidenti të Republikës, të kryeministrit ose të një të tretës (1/3) së deputetëve.

Kërkesa e cekur më lart nuk i ka 40 nënshkrime të deputetëve.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën 15:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.